FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 80	2002	Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8958 datë 24.10.2002	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Fondit të OPEC-ut për rehabilitimin e furnizimit me ujë"……	2293
Ligj nr. 8959 datë 24.10.2002	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës për bashkëfinancimin e projektit të punëve të komunitetit"……	2302
Ligj nr. 8961 datë 24.10.2002	Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7870, datë 13.4.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet përkatëse…….	2313
Ligj nr. 8962 datë 24.10.2002	Për një ndryshim në ligjin nr.8734, datë 1.2.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike"……..	2315
Ligj nr.8963 datë 24.10.2002	Për një shtesë në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", me ndryshimet	

	përkatëse…….	2316
Ligj nr. 8970 datë 14.11.2002	Për një ndryshim në ligjin nr. 8739, datë 12.2.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve nën presion"……	2317
Dekret nr. 3572 datë 27.11.2002	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare……..	2317
Dekret nr. 3576 datë 27.11.2002	Për dhënie dhe lejim lënie të shtetësisë shqiptare…….	2318
	Shpallje kërkese për shpronësim për ndërtim të objektit të segmentit rrugor Link-Road që lidh Interchange Shkozet, me rrugën nacionale Tiranë-Durrës……..	2319

L I G J
Nr. 8958, datë 24.10.2002

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË KREDISË NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE FONDIT TË OPEC-UT PËR REHABILITIMIN E FURNIZIMIT ME UJË"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Fondit të OPEC-ut për rehabilitimin e furnizimit me ujë" në shumën 2 700 000 (dy milionë e shtatëqind mijë) USD.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3590, datë 10.12.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

HUAJA NR.895 P

MARREVESHJE
HUAJE MIDIS REPUBLIKES SE SHQIPERISE DHE FONDIT TE OPEC PER ZHVILLIMIN NDERKOMBETAR PROJEKTI I REHABILITIMIT TE FURNIZIMIT ME UJE

Marreveshja date 31.7.2002 ndermjet Republikes se Shqiperise (qe ketej e tutje te quajtur Huamarresi) dhe Fondi i OPEC-ut per Fondin per Zhvillimin Nderkombetar (qe tani e tutje te quajtur Fondi).

Ndersa Vendet Anetare te OPEC-ut, duke qene te ndergjegjeshme per nevojat per solidaritet mes te gjitha vendeve ne zhvillim dhe te ndergjegjeshme per rendesine e kooperimit financiar mes tyre dhe te tjera vendeve ne zhvillim, kane ngritur Fondin per te siguruar mbeshtetje financiare per vendet e vonuara ne terma koncensionale, ne vazhdim te rrugeve bilaterale dhe multilaterale nepermjet te cilave Vendet Anetare te OPEC-ut zgjerojne asistencen financiare per vendet e tjera ne zhvillim;

Dhe ndersa Huamarresi ka kerkuar asistence nga Fondi per financimin e Projektit te pershkruar ne aneksin 1 te kesaj Marreveshje;

Dhe ndersa Bordi Udheheqes i Fondit ka aprovuar levrimin e nje Huaje per Huamarresin ne shumen e dy milion e shtateqindmije USD (USD 2.700.000) sipas termave dhe kushteve te parashtruara ketu;

Tani dhe per kete aresye, Palet ketu poshte bien dakord sa me poshte:

Neni 1
Perkufizime

1.01. Kudo qe eshte perdorur ne kete Marreveshje, me perjashtim te rasteve ku nga konteksti kerkohet te nenkuptohet e kunderta, termat e meposhtme do te kene kuptimet e meposhtme:

(a) "Fondi" do te thote Fondi i OPEC-ut per Zhvillimin Nderkombetar te ngritur nga Vendet

Anetare te Organizates se Vendeve Eksportuese te Naftes (OPEC) ne baze te Marreveshjes te nenshkruar ne Paris ne 28 janar 1976, siç eshte amenduar.

(b) "Menaxhuesi i Fondit" do te thote Drejtori i Pegjitheshem i Fondit ose perfaqesuesi i tij i autorizuar.

(c) "Huaja" do te thote Huaja e perftuar nepermjet kesaj Marreveshjeje.

(d) "Dollar" ose shenja $ do te thote monedha e SHBA-së.

(e) "Projekti" do te thote Projekti per te cilin eshte dhene Huaja siç eshte pershkruar ne aneksin 1 te kesaj Marreveshje dhe siç mund te jete amenduar ky pershkrim here pas here nepermjet marreveshjeve midis Huamarresit dhe Menaxhuesit te Fondit.

(f) "Mallrat" do te thote pajisjet, furnizimet dhe sherbimet e kerkuara per Projektin. Referenca e kostove te mallrave do te kerkohet te perfshije gjithashtu koston e importimit te ketyre mallrave ne territorin e Huamarresit.

(g) "Agjencia Ekzekutive" do te thote Ministria e Rregullimit te Territorit dhe Turizmit te Huamarresit ose nje agjenci tjeter, e tille siç mundet te bihet dakord midis Huamarresit dhe Menaxhuesit te Fondit.

(h) "Data e mbylljes" do te thote data e specifikuar nen ose sipas seksionit 2.10 te kesaj Marreveshje.

(i) "Data efektive" do te thote data ne te cilen kjo Marreveshje do te hyje ne fuqi dhe do te behet efektive.

Neni 2
Huaja

2.01 Nje hua ne shumen e dy milion e shtateqindmije USD (USD 2.700.000) jepet nga Fondi, per Huamarresin sipas termave dhe kushteve te parashtruara ne kete Marreveshje.

2.02 Huamarresi do te paguaje interesat ne tarifen e 1, 3/4 per qind (1,75%) per vit mbi shumen kryesore te terheqjes se Huase dhe te papaguar, here pas here.

2.03 Huamarresi do te paguaje here pas here nje tarife sherbimi ne shumen e nje per qind per vit mbi shumen kryesore te terheqjes se Huase dhe te papaguar, qe duhet te perputhen me shpenzimet e administrimit te Huase.

2.04 Interesat dhe tarifat e sherbimit do te paguhen ne dollare ne gjysem viti ne 15 shkurt dhe 15 gusht te çdo viti ne llogarine e Fondit te caktuar per kete qellim nga Menaxhuesi i Fondit.

2.05 Mbasi kjo Marreveshje eshte deklaruar efektive ne perputhje me seksionin 7.01, dhe ne qofte se Huamarresi dhe Fondi nuk do te bien dakord per te kunderten, te ardhurat e Huase mund te terhiqen here pas here sipas shpenzimeve te bera pas 28 gushtit 2001, ose qe do te behen ne data te mevoneshme ne perputhje me kostot e arsyeshme te mallrave te kerkuara per Projektin, te cilat do te financohen jashte te ardhurave te Huase siç eshte percaktuar ne aneksin 2 te kesaj Marreveshjeje dhe ne amendamentet e nje aneksi te tille te aprovuar siç duhet nga Menaxhuesi i Fondit.

2.06 Me perjashtim te rasteve kur Menaxhuesi i Fondit do te bjere dakord per te kunderten, terheqjet nga Huaja mund te behen ne monedhat ne te cilat jane paguar ose jane te pagueshme shpenzimet e referuara ne seksionin 2.05. Ne rast se pagesa do te kerkohet ne nje monedhe te ndryshme nga dollari, kjo pagese do te konvertohet ne baze te kostos ne dollare qe dalin nga Fondi per plotesimin e kerkeses. Menaxhuesi i Fondit do te veproje ne blerjen e monedhave si agjent i Huamarresit. Terheqjet ne perputhje me shpenzimet ne monedhen e Huamarresit, nese ka, do te behen ne dollare sipas tarifes zyrtare te kembimit ne kohen e terheqjes, dhe ne mungese te nje tarife te tille ne perputhje me nje tarife te aresyshme si do te vendose Menaxhuesi i Fondit here pas here.

2.07 Te gjitha aplikimet per terheqje do te pergatiten ne perputhje me "Procedurat e disbursimit te Fondit te OPEC-ut per Zhvillimin Nderkombetar" siç eshte aprovuar ne maj 1983, nje kopje e te ciles i eshte paraqitur Huamarresit. Nje kopje origjinale e secilit aplikim te tille per terheqje do te paraqitet qe ketej e tutje per Fondin nga perfaqesuesi i Huamarresit te percaktuar ne, ose ne perputhje me seksionin 8.02. Çdo aplikim i paraqitur keshtu do te shoqerohet me dokumente te tilla dhe te tjera evidenca te mjaftueshme ne forme dhe ne permbajtje, te tilla qe te jene ne perputhje me kerkesat e Menaxhuesit te Fondit qe Huamarresi eshte ngarkuar te terheqe nga Huaja shumen e aplikuar dhe qe shuma qe do te terhiqet do te perdoret ekskluzivisht per qellimet e specifikuara ne kete Marreveshje.

2.08 Huamarresi do te shlyeje shumen kryesore te Huase ne dollare, ose ne ndonje monedhe tjeter lirisht te konvertueshme te pranueshme per Fondin e Menaxhimit ne nje shume ekuivalente ne shumen perkatese ne dollare, ne perputhje me kursin e kembimit te tregut te vlefshem ne vendin dhe kohen e shlyerjes se kestit. Shlyerja do te behet ne 30 keste te barabarta gjysem vjetore duke filluar nga 15 gusht 2007, pas nje periudhe te grace (falas) qe vazhdon deri ne kete date, dhe me pas ne perputhje me aneksin e Amortizimit te aneksuar ne kete Marreveshje. Çdo kest do te behet ne shumen e 90.000 USD (nenetedhjete mije dollare). Te gjitha keto keste do te transferohen ne daten e shlyerjes ne llogarine e Fondit siç kerkohet nga Menaxhuesi i Fondit.

2.09. (a) Huamarresi merr persiper qe te siguroje qe asnje borxh tjeter i jashtem nuk do te kete prioritet mbi kete hua ne alokimin, realizimin ose shperndarjen e bashkepunimeve me e vendet huaja te mbajtura nen kontroll ose ne favor te Huamarresit. Se fundi, nese do te krijohet ndonje hipoteke mbi ndonje nga asetet publike (siç percaktohet ne Seksionin 2.09(c)), si siguri per ndonje hua te jashtme, i cili do te ose mundet te rezultonte si prioritet ne favor te kreditorit te Huase te jashtme ne alokimin, realizimin ose shperndarjen e marredhenieve te bashkepunimit me vendet e huaja, kjo hipoteke do te siguroje ne menyre te njete dhe proporcionale, ipso facto dhe pa konseguenca kostoje per Fondin, pricipalin dhe interesat mbi huane dhe Huamarresi, ose ne krijimin ose lejimin e krijimit te nje hipoteke te tille, do te garantoje efektet e tij, me kusht qe nese per ndonje aresye konstitucionale ose te tjera arsye legale nuk eshte e mundur te zbatohet hipoteka e krijuar mbi ndonje nga asetet i ndonjerit prej nendarjeve te tij politike ose administrative, Huamamrresi do te siguroje menjehere dhe kundrejt asnje kostoje per Fondin shumen kryesore dhe perqindjet, e Huase nepermjet nje hipoteke ekuivalente ose te tjera asete publike te kenaqeshme per Fondin.

(b) Marreveshja e mesiperme (pika a) nuk do te zbatohet mbi:

i. ndonje hipoteke te krijuar ne pronen, ne kohen e blerjes se saj, vetem si siguri per pagesen e çmimit te blerjes te kesaj prone; dhe

ii. ndonje hipoteke te krijuar gjate kursit te zakonshem te transaksioneve bankare dhe qe sigurojne nje maturim te Huase jo me shume se nje vit mbas dates se tij.

(c) Sic eshte perdorur ne kete seksion, termi “asete publike” do te thote asetet e Huamarresit, ose te ndonje nenndarje politike ose administrative te ndonje njesie te zoteruar ose te kontrolluar nga, ose qe operon per llogari ose perfitim te, Huamarresit ose te ndonje nenndarje te tille, duke perfshire arin dhe te tjera asete shkembimi te mbajtur nga ndonje institucion qe kryen funksionet e nje Banke qendrore ose nje Fondi shkembimi te stabilizimit, ose funksione te ngjashme, per Huamarresin.

2.10. E drejta e Huamarresit qe te beje terheqje nga te ardhurat e Huase do te perfundoje ne 30 qershor 2004, ose ne nje date te tille te mevonshme siç do te vendoset nga Menaxhuesi i Fondit. Menaxhuesi i Fondit do te informoje menjehere Huamarresin per nje date te tille te mevoneshme.

Neni 3
Zbatimi i Projektit: prokurimi

3.01. Huamarresi do te zbatoje Projektin me diligjencen e duhur dhe efikasitetin dhe ne konformitet me praktikat kryesore administrative, financiare dhe inxhinierike, dhe do te siguroje, menjehere sipas nevojes, fondet, facilitetet, sherbimet dhe te tjera resurse, ne vazhdim te te ardhurave te Huase, te kerkuara per kete qellim.

3.02. Huamarresi do te siguroje qe aktivitetet e departamenteve te tij dhe agjensive qe kane lidhje me zbatimin e Projekteve te udhehiqen dhe te koordinohen ne perputhje me procedurat dhe politikat administrative kryesore.

3.03 a. Huamarresi merr persiper te siguroje, ose te beje furnizimin e mjaftueshem per sigurimin e mallrave te importuara qe do te financohen jashte Huase perkundrejt rrezikut te incidenteve per sigurimin, transportimin dhe dergimin e tyre ne vendin e perdorimit ose te instalimit, dhe per nje siguri te tille çdo dem do te jete i pagueshem ne nje monedhe te perdorshme lirisht nga Huamarresi per te zevendesuar ose riparuar mallra te tilla.

b. Perveçse kur Fondi do te bjere dakord per te kunderten, te gjitha mallrat dhe sherbimet te financuara jashte te ardhurave te Huase, do te perdoren ekskluzivisht per Projektin.

c. Me perjashtim te rasteve kur bihet dakord per te kunderten mes Huamarresit dhe Fondit, do te aplikohen per prokurimin e mallrave nen kete Marreveshje “Udhezuesit e Prokurimit ne Huate e dhena nga Fondet e OPEC” siç ato jane aprovuar ne 2 nentor 1982, nje kopje e te cilave eshte

furnizuar per Huamarresin.

3.04 (a) Huamarresi do te pajise Menaxhuesin e Fondit, menjehere me pergatitjen e tyre, me planet, karakteristikat, dokumentet e Kontrates dhe anekset e ndertimit dhe prokurimit per Projektin dhe çdo modifikim material te tyre ose te shtesave te tyre, ne detaje te tilla siç do te kerkoje ne menyre te aresyshme Menaxhuesi i Fondit.

(b) Huamarresi:

(i) do te ruaje regjistrat dhe procedurat adekuate per te regjistruar dhe monitoruar progresin e Projektit (duke perfshire kostot e tij dhe perfitimet qe do te rrjedhin prej tij) te identifikoje mallrat dhe sherbimet e financuar jashte te ardhuarve te Huase, dhe te perdore ato per Projektin;

(ii) do te aftesoje perfaqesuesit e Menaxhuesit e Fondit te vizitojne facilitetet dhe kantieret e ndertimit te perfshire ne Projekt dhe te ekzaminoje mallrat dhe punimet e financuar jashte te ardhuarve te Huase dhe te gjitha regjistrat dhe dokumetet perkatese; dhe

(iii) do te pajise Menaxhuesin e Fondit ne intervale te rregullta me te gjitha informacionet e tilla te nevojeshme siç do te kerkoje Menaxhuesi i Fondit ne menyre te arsyeshme ne lidhje me projektin, kostot e tij, dhe aty ku duhet perfitimet qe rrjedhin prej tij, shpenzimet e te ardhurave te borxhit dhe mallrat, punimet dhe shpenzimet e financuara jashte te ardhurave te tilla po ashtu si nje raport tremujor mbi progresin e implementimit te Projektit dhe nje rishikim afatmesem.

c. Menjehere me kompletimin e Projektit, por sidoqofte jo me vone se gjashte muaj mbas dates se mbylljes ose nje date te tille te mevoneshme, siç mund te bihet dakord per kete qellim midis Huamarresit dhe Menaxhuesit te Fondit, Huamarresi do te pergatise dhe pajise Menaxhuesin e Fondit me nje raport, per qellimet dhe detajet e tilla siç mund te kerkoje ne menyre te aresyeshme Menaxhuesi i Fondit, per ekzekutimin dhe veprimtarine fillestare te Projektit, kostot e tij dhe perfitimet e rrjedhura dhe qe do te rrjedhin prej tij, performanca nga Huamarresi dhe nga Fondi te detyrimeve te tyre respektive nen kete Marreveshje dhe arritjen e qellimeve te Huase.

3.05 Huamarresi do te ruaje ose do te detyroje te ruhen regjistra te pershtatshem per te reflektuar ne perputhje me praktikat llogaritese te duhura te ruajtura ne menyre konsistente, veprimtarite, resurset dhe shpenzimet, qe i perkasin Projektit, te departamenteve ose agjencive te Huamarresit pergjegjes per zbatimin e Projektit ose nje pjese te tij dhe t'i bejne fonde te tilla te disponueshme per Menaxhuesin e Fondit me kerkesen e tij.

3.06 (a) Huamarresi dhe Fondi do te kooperojne plotesisht per te siguruar qe qellimet e Huase te arrihen.

(b) Huamarresi do te njoftoje menjehere Menaxhuesin e Fondit per ndonje kusht i cili nderhyn me, ose kercenon te nderhyje me, progresin e Projektit, performancen e detyrimeve te tij nen kete Marreveshje ose arritjen e qellimeve te Huase.

(c) Huamarresi dhe Fondi here pas here me kerkesen e seciles pale do te shkembejne pikepamje nepermjet perfaqesuesve te tyre ne lidhje me ato çeshtje qe i referohen Projektit dhe Huase.

3.07. Te gjitha referencat per Huamarresin ne kete nen do te konsiderohen mutates mutandis, sikur te perfshijne referencat per agjencine ekzekutuese.

Neni 4
Perjashtimet

4.01. Kjo Marreveshje dhe çdo Marreveshje suplementare mes paleve per te do te jene te çliruara nga çdo takse, detyrim, ose detyrime doganore te nxjerra nga ose qe jane ne fuqi ne vendin e Huamarresit mbi, ose ne lidhje me ekzekutimin, levrimin ose regjistrimin e saj.

4.02. Shuma kryesore, si edhe tarifat e sherbimit dhe interesat e Huase do te paguhen pa deduktime prej, dhe do te jene te çliruara nga te gjitha tarifat dhe kufizimet e ndonje lloji te imponuara (qe jane ne fuqi) ne ose nga vendi i Huadhenesit.

4.03. Te gjitha dokumentet e Fondit, regjistrat, korrespondenca dhe materiale te tjera te ngjashme do te konsiderohen si konfidenciale nga Huamarresi, me perjashtim te rasteve kur nga Fondi bihet dakord per te kunderten.

4.04. Fondi dhe asetet e tij nuk do te jene subjekt i ndonje mase te shpronesimit, nacionalizimit, sekuestrimit, kujdestarise ose konfiskimit ne territorin e Huamarresit.

Neni 5
Pershpejtimi i maturimit; pezullimi dhe anullimi

5.01. Ne qofte se do te ndodhe ndonje nga situatat e meposhteme dhe kjo situate do te vazhdoje per periudhat e specifikuara me poshte, atehere ne kohen ne vazhdim te kesaj situate Menaxhuesi i Fondit mundet, nepermjet njoftimit per Huamarresin te kerkoje qe pjesa kryesore (principal) e Huase te mbetur e papaguar te behet menjehere e pagueshme se bashku me interesat dhe tarifat e sherbimit te tij dhe ne kete rast Huaja, se bashku me interesat dhe te gjitha tarifat, duhet te behet menjehere e pagueshme:

(a) ne qofte se ndodh dhe vazhdon per nje periudhe prej 30 ditesh nje mospagim i ndonjerit prej keseteve te Huase kryesore ose te interesit ose te tarifave te sherbimit te tij, qe jane nen kete Marreveshje ose nen nje Marreveshje tjeter sipas se ciles Huamarresi ka marre ose do te kete marre nje hua nga Fondi;

(b) ne rast moszbatimi te performances ose te ndonje obligimi tjeter nga ana e Huamarresit nen kete Marreveshje ose nen Marreveshjen e Projektit, nese ka, dhe nje moszbatim i tille do te vazhdoje per nje periudhe prej 60 ditesh mbas njoftimit qe eshte dhene per te nga Fondi per Huamarresin.

5.02. Huamarresi mundet, nepermjet nje njoftimi te bere Fondit te anuloje çdo shume te Huase te cilen Huamarresi nuk e ka terhequr perpara dhenies se nje njoftimi te tille. Fondi mundet nepermjet nje njoftimi te bere Huamarresit te pezulloje ose t'i jape fund te drejtes se Huamarresit per te bere terheqje nga Huaja nese ndodh ndonje nga situatat e permenduara ne seksionin 5.01 (a) dhe (b) ose ndonje situate tjeter e jashtezakonshme, e cila do ta bente te pamundur zbatimin e suksesshem te projektit ose e ben Huamarresin te paafte per te kryer detyrimet e tij nen Kontrate.

5.03. Pavaresisht nga pershpejtimi i maturimit te Huase sipas seksionit 5.01 ose pezullimi apo anulimi i tij sipas seksionit 5.02 te gjitha kushtet e kesaj Marreveshje do te vazhdojne te mbeten ne fuqi dhe efektive, perveç sic kushtezohet ne menyre specifike ne kete nen.

5.04. Perveçse kur bihet dakord per te kunderten midis Huamarresit dhe Menaxhuesit te Fondit, çdo anulim do te aplikohet pro rata ndaj disa maturimeve te shumes kryesore te Huase te cilat do te maturohen mbas dates se nje anulimi te tille.

Neni 6
Detyrimi, anulimi i Fondit, arbitrimi

6.01. Te drejtat dhe detyrimet e paleve nen kete Marreveshje do te jene te vlefshme dhe te detyrueshme ne perputhje me termat e tyre, pavaresisht nga ndonje ligj lokal per te kunderten. Asnje nga Palet e kesaj Marreveshje nuk do te kete te drejte nen ndonje situate qe te deklaroje ndonje pretendim qe ndonje nga kushtet e kesaj Marreveshje eshte e pavlefshme ose e padetyrueshme per ndonje arsye.

6.02. Menaxhuesi i Fondit do te informoje menjehere Huamarresin sa here qe te merret ndonje vendim per mbylljen e Fondit ne perputhje me Marreveshjen e dhenies se Fondit. Ne rast te nje mbylljeje te tille, kjo Marreveshje Huaje do te mbetet ne fuqi dhe efektive dhe Menaxhuesi i Fondit do te keshilloje Huamarresin per Marreveshje alternative per shlyerejen e Huase siç mund te vendoset nga autoritetet e duhura te Fondit per raste te tilla.

6.03. Palet ne kete Marreveshje do te perpiqen te zgjidhin ne menyre miqesore te gjitha kontradiktat ose divergjencat midis tyre qe rrjedhin nga kjo Marreveshje ose ne lidhje me te. Ne qofte se divergjencat ose kontradiktat nuk mund te zgjidhen ne menyre miqesore, ato do te paraqiten per gjykim nga Gjykata e Arbitrimit, ashtu siç do te kushtezohet ketu poshte:

(a) Procedurat e arbitrimit mund te institucionalizohen nga Huamarresi kunder Fondit ose anasjelltas. Ne te gjitha rastet procedurat e arbitrimit do te institucionalizohen nga nje njoftim i dhene nga nje Pale (ajo ankuese) per Palen tjeter (ate pergjegjese).

(b) Gjykata e Arbitrimit do te perbehet nga tre arbitrues te caktuar si me poshte: njeri nga pala reklamuese, nje i dyte nga Pala pergjegjese dhe nje i trete (qe ketej e tutje te quajtur Arbiter) nga marreveshja e dy arbitruesve. Nese brenda 30 ditesh mbas njoftimit te procedurave te institucionit te arbitrimit Pala pergjegjese nuk mundet te caktoje nje arbitrues, ky i fundit so te caktohet nga Presidenti i Keshillit Nderkombetar te Drejtesise me kerkesen e Pales qe institucionalizon procedurat.

Nese te dy arbitruesit nuk arrijne te bien dakort per Arbitrin brenda 60 diteve pas dates se caktimit te arbitruesit te dyte, ky arbitrues do te caktohet nga Presidenti i Keshillit Nderkombetar te Drejtesise.

(c) Gjykata e Arbitrimit do te mblidhet ne kohen dhe vendin e fiksuar nga Arbitruesi. Me pas ajo do te vendose ku dhe kur ajo do te qendroje. Gjykata e Arbitrimit do te vendose te gjitha ceshtjet e procedures dhe ceshtjet ne lidhje me kompetencat e saj.

(d) Te gjitha vendimet e Gjykates se Arbitrimit do te merren me vote maxhoritare. Shpallja vendimit te Gjykates, e cila mund te mbahet edhe nese njera nga palet deshton, do te jete perfundimtar dhe e detyrueshme per te dy Palet ne procedurat e arbitrimit.

(e) Sherbimet e ndonje njoftimi ose procesi ne lidhje me çdo procedure nen kete Seksion ose ne lidhje me çdo procedure per te detyruar ndonje shpallje vendimi te mbajtur ne perputhje me kete Seksion do te behen ne menyren e kushtezuar ne seksionin 8.01.

(f) Gjykata e Arbitrimit do te vendose mbi menyren ne te cilen kostoja e arbitrimit do te jete e zbatueshme nga secila ose te dyja Palet qe kane kontradikta.

Neni 7
Data efektive: Perfundimi i kesaj Marreveshjeje

7.01. Kjo Marreveshje do te behet efektive ne daten ne te cilen Fondi i dergon Huamarresit njoftim per pranimin nga ana e tij te evidencave te kerkuara nga seksionet 7.02 dhe 7.03.

7.02. Huamarresi do te pajise Fondin me prova te mjaftueshme qe zbatimi dhe levrimi i kesaj Marreveshjeje nga ana e Huamarresit eshte autorizuar siç duhet dhe ratifikuar sipas kerkesave konstitucionale te Huamarresit.

7.03. Ne perputhje me Seksionin 7.02, Huamarresi gjithashtu do te pajise Fondin me nje Çertifikate te nxjerre nga Ministri i Drejtesise ose Prokuroria e Pergjitheshme ose Departamenti Qeveritar Ligjor kompetent perkates, qe tregon se kjo Marreveshje eshte autorizuar dhe ratifikuar siç duhet nga Huamarresi dhe kushtezon nje detyrim te vlefshem dhe te detyrueshem te Huamarresit ne perputhje me termat e saj.

7.04. Nese kjo Marreveshje nuk do te hyje ne fuqi dhe te behet efektive nga 31 tetor 2002 kjo Marreveshje dhe te gjitha detyrimet e paleve ketu do te anulohen, me perjashtim te rasteve kur Fondi pas konsideratave te arsyeve per vonese, do te vendose nje date te mevonshme per qellimet e ketij Seksioni.

7.05. Kur e gjitha shuma fillestare e Huase do te jete shlyer dhe interesat dhe te gjitha detyrimet te cilat kane rjedhur nga Huaja do te jene paguar, kjo Marreveshje dhe te gjitha detyrimet e Paleve ketu poshte do te quhen te perfunduara.

Neni 8
Njoftimi: prezantimi, modifikimet

8.01. Çdo njoftim ose kerkese e kerkuar ose e lejuar qe te jepet ose te behet nen kete Marreveshje do te jete me shkrim. Te tilla njoftime ose kerkesa do te kerkohet te jene dhene ose te behen siç duhet kur ato dergohen me dore, e-mail, telefon, teleks ose telefaks per Palen e cila kerkohet te dergohet ose behet, ne adresen e pales te specifikuar me poshte ose ne ndonje adrese tjeter siç mund te kete specifikuar Pala derguese me shkrim ndaj Pales qe i jep njoftimin ose qe ben kerkesen.

8.02. Çdo veprim ose kerkese e kerkuar ose e lejuar qe te merret dhe çdo dokument i kerkuar ose i lejuar qe te zbatohet nen kete Marreveshje nga ana e Huamarresit do te ndermerret ose zbatohet nga Ministri i Financave te Huamarresit ose nje tjeter zyrtar i autorizuar nga ai me shkrim.

8.03. Çdo modifikim i kushteve te kesaj Marreveshjeje mund te arrihet per Palen e Fondit nga Kryetari i Bordit Udheheqes te Fondit dhe nga ana e Huamarresit me Marreveshje me shkrim te ekzekutuar nga ana e Huamarresit nga perfaqesuesi i caktuar ne lidhje me, ose ne perputhje me seksionin 8.02, me kushtin qe sipas opinionit te perfaqesuesve te tille modifikimi eshte i arsyeshem per rrethanat dhe nuk do te rrise ne menyre thelbesore obligimet e Huamarresit nen kete Marreveshje. Fondi mund te pranoje zbatimin nga keto perfaqesues te ndonje modifikimi te tille si evidence definitiv qe sipas opinionit te Huamarresit modifikimi ose amplifikimi i kerkuar nuk do te rrise ne menyre thelbesore detyrimet e Huamarresit te perfshira ketu.

8.04. Çdo dokument i levruar sipas kesaj Marreveshjeje do te behet ne gjuhen angleze.

Dokumentet ne ndonje gjuhe tjeter do te shoqerohen nga perkthimi anglisht i tij, i certifikuar si nje perkthim i aprovuar dhe ky perkthim i aprovuar do te jete definitiv ndermjet paleve ketu.

Ne prani te tyre, Palet ketu poshte, duke vepruar nepermjet perfaqesuesve te tyre te autorizuar, kane nenshkruar kete Marreveshje dhe derguar ne Vjene 3 kopje ne anglisht, secila e konsideruar si origjinal i njejte dhe efektiv ne diten dhe vitin e shkruar me siper.

PER HUAMARRESIN

Emri znj. Shpresa Kureta
Ambasadore e Republikës së Shqipërisë në Austri
AdresaMinistria e Financave
Bulevardi "Deshmoret e Kombit"
Tirane
Republika e Shqiperise

Tel/Fax: 355-42-289494

PER FONDIN E OPEC-UT PER ZHVILLIMIN NDERKOMBETAR

Emri Dr. Saleh Al-Omair
Shef i Bordit Drejtues
AdresaFondi i Opec per Zhvillimin Nderkombetar
Kutia Postare Box 995
A-1011 Viena
Austri

Kabell: OPECFUND

Tel/fax:131734 FUND A
Telefax:5139238
ANEKSET

Aneksi 1: Pershkrimi i Projektit
Aneksi 2: Alokimi i Huase
Aneksi 3: Lsta e amortizimit

ANEKSI 1
PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti ka si qellim permiresimin e sherbimeve baze te furnizimit me uje dhe reduktimin e kostove operacionale nepermjet rehabilitimit te sistemit te furnizimit me uje mbarekombetar, por me prioritet ne bashkite kryesore te Durresit, Fierit Lezhes dhe Sarandes. Projekti perbehet nga komponentet e meposhtem:

(a) punime civile, qe mbulojne riparimin dhe zevendesimin e puseve, rezervuareve te depozitimit, stacioneve te pompimit, tubacioneve te transmetimit dhe rrjeteve shperndares, furnizimi dhe instalimi i klorinatoreve tubacioneve, dhe pajisjeve, po ashtu si furnizimi i materialeve dhe pjeset e kembimit per mirembajtjen dhe riparimin e rrjedhjeve ne vend ne sistemet e shperndarjes se ujit;

(b) sherbimet e konsulences perbehen nga angazhimi i konsulenteve ne zbatimin e projektimit dhe supervizionit te ndertimeve, rehabilitimin dhe punimet e instalimit, po ashtu si ne pergatitjen e projekteve dhe dokumenteve te tenderit, se bashku me sigurimin e asistences teknike per PIU (Njesia e Zbatimit te Projektit); dhe

(c) mbeshtetja e PIU-ut, perballimin e mbulimit te kostove per mbeshtetjen logjistike te PIU-ut, pajisje zyrash, mjete, automjete.

ANEKSI 2
ALOKIMI I HUASE

1. Me perjashtim te rasteve kur bihet dakord nga te dy Palet (Huamarresi dhe Menaxhuesi i Fondit) per te kunderten, te ardhurat e Huase prej 2,700,000 USD do te perdoren per financimin 100% te kostove totale te punimeve civile komponentet e Projektit, siç eshte pershkruar ne paragrafin (a) te aneksit 1 te kesaj Marreveshjeje dhe ne veçanti, nenprojektet e vendosur ne zonen 10 te te hapesires rurale Durres.

2. Pavaresisht nga alokimi i te ardhurave te Huase ose perqindja e disbursimit e parashtruar ne paragrafin 1 te mesiperm, ne qofte se Menaxhuesi i Fondit ka vleresuar ne menyre te arsyeshme qe shuma e Huase te alokuar ne komponentin e specifikuar me siper do te jete e pamjaftueshme per te financuar perqindjen e rene dakord te te gjitha shpenzimeve ne kete komponent, Menaxhuesi i Fondit mundet, me njoftimin per Huamarresin, te zvogeloje perqindjen e disbursimit te aplikueshem per shpenzime te tilla, me qellim qe terheqjet e tjera ne lidhje me komponentin e cituar te mund te vazhdojne derisa te gjitha shpenzimet nen te te jene bere.

ANEKSI 3
LISTA E AMORTIZIMIT

Data e Shlyerjes	Shuma (e shprehur ne USD)
15 Gusht 2007	90.000
15 Shkurt 2008	90.000
15 Gusht 2008	90.000
15 Shkurt 2009	90.000
15 Gusht 2009	90.000
15 Shkurt 2010	90.000
15 Gusht 2010	90.000
15 Shkurt 2011	90.000
15 Gusht 2011	90.000
15 Shkurt 2012	90.000
15 Gusht 2012	90.000
15 Shkurt 2013	90.000
15 Gusht 2013	90.000
15 Shkurt 2014	90.000
15 Gusht 2014	90.000
15 Shkurt 2015	90.000
15 Gusht 2015	90.000
15 Shkurt 2016	90.000
15 Gusht 2016	90.000
15 Shkurt 2017	90.000
15 Gusht 2017	90.000
15 Shkurt 2018	90.000
15 Gusht 2018	90.000
15 Shkurt 2019	90.000
15 Gusht 2019	90.000
15 Shkurt 2020	90.000
15 Gusht 2020	90.000
15 Shkurt 2021	90.000
15 Gusht 2021	90.000
15 Gusht 2022	90.000
Total	2.700.000

L I G J
Nr. 8959, datë 24.10.2002

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË KREDISË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EUROPËS PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT TË PUNËVE TË KOMUNITETIT"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e kredisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës për bashkëfinancimin e projektit të punëve të komunitetit".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3591, datë 10.12.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

MARREVESHJA
E KREDISE MIDIS BANKES PER ZHVILLIM TE KESHILLIT TE EUROPES
DHE REPUBLIKES SE SHQIPERISE

Banka per Zhvillim e Keshillit te Europes (tani e tutje e quajtur BKE), Paris, nga njera ane
dhe, Republika e Shqiperise , nga ana tjetër
Duke marre parasysh aplikimin e qeverisë së Shqiperise date 12 mars 2001;
Duke marre parasysh rezoluten e Këshillit Administrativ te BKE:1424 (1997) rev.3;
Duke marre parasysh Protokollin e Trete te Marreveshjes se Pergjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Keshillit te Europes;
Duke marre parasysh nenet e Rregullores per Kredine te BKE-së date 6 tetor 1970 (botuar nentor 1999);
kane rene dakord si me poshte:

Neni 1

Kjo kredi jepet sipas kushteve te pergjithshme te Rregullores aktuale te Kredise se Bankes per Zhvillim te Keshillit te Europes dhe sipas kushteve te veçanta te caktuara nga kjo Marreveshje dhe shtojcat e saj.

Neni 2
Projekti

Banka e Keshillit te Europes i jep Huamarresit, i cili pranon, nje kredi per financim te pjesshem te F/P 1397(2001) miratuar nga Keshilli Administrativ i Bankes se Keshillit te Europes me 21 maj 2001 (data e miratimit) lidhur me financimin e pjeseshem te Projektit te Puneve te Komunitetit Lokal.

Kjo kredi jepet nga BKE duke marre parasysh angazhimin qe Huamarresi ka marre per ta

perdorur ate vetem per te financuar projektin pershkruar ne shtojcen I dhe, te realizoje kete projekt sipas kushteve te cilat jane shpjeguar me hollesi ne Shtojcen ne fjale.

Çdo ndryshim ne zbatimin e kredise qe nuk ka marre miratimin e BKE-së mund te çoje ne pezullimin, anullimin ose ne rikthimin e menjehershem te kredise sipas kushteve ne nenin 13 te Rregullores se Kredise.

Neni 3
Kredia

3.1 Kushtet financiare

Shuma e miratuar e kredise se dhene eshte deri ne ekuivalentin e:

3, 400, 000 USD

(tremilion e katerqind mije dollare amerikan)

Kredia do te disbursohet ne disa keste.

3.2. Aktivizimi

Per te aktivizuar kredine, Huamarresi duhet t'i leshoje BKE-së ne kohe per çdo kest nje (Promissory Note) Vertetim-Premtues te veçante si shembulli ne shtojcen III.

Vertetimi Premtues duhet te leshohet dhe te jete i pagueshem ne USD.

3.3. Vendi

E gjithe shuma qe duhet paguar nga Huamarresi sipas kesaj kredie paguhet ne BKE ne USD dhe ne numrin e llogarise i cili i behet e ditur Huamarresit nga BKE ne kohen e disbursimit te çdo kesti. Fax –et ose Swiftet duhet te dergohen ne BKE nga Banka qe Huamarresi ka zgjedhur per te bere pagesat te pakten 5 dite pune para njoftimit per secilen pagese.

3.4 Datat

Dispozitat e nenit 3 i nenshtrohen rregullores se " Konventa e Ndryshuar e Dites se Punes", perkufizimi i te ciles gjendet ne shtojcen IV te "Marreveshjes aktuale te Kredise ("Dite Pune" do te thote nje dite pune ne vendin e monedhes).

Neni 4
Monitorimi i Kredise dhe Projektit

4.1. Perdorimi i Kredise

4.1.1 Fondi i Zhvillimit Shqiptar.

Ky projekt do te zbatohet nga Fondi i Zhvillimit Shqiptar (FZHSH).

4.1.2 Periudha

Kredia sipas çdo kesti duhet te perdoret nga Huamarresi per financimin e Projektit brenda 6 muajve nga disbursimi i tij nga BKE.

Shumat e kredise te cilat nuk jane perdorur ose alokuar brenda kesaj periudhe duhet te shlyhen ne BKE maksimumi brenda 30 diteve.

Huamarresi merr persiper te mbuloj koston qe rezulton nga kjo shlyerje. Kjo kosto duhet te korrespondoje me koston qe Banka e Keshillit te Europes duhet te perballoje si rezultat i zevendesimit te se njejtes shume, ne daten e shlyerjes per afatin e mbetur te kredise fillestare. Norma e zevendesimit duhet te caktohet nga BKE-ja bazuar ne kushtet e tregut per daten e shlyerjes dhe per periudhen ne fjale. Prandaj, kostoja duhet te llogaritet duke marre parasysh diferencen midis normes se kredise fillestare dhe te rikthimit.

Per me tej, nese shuma e kestit te kredise disbursuar nga BKE-ja brenda kesaj periudhe nuk alokohet te kontraktoret ose alokohet pjeserisht, kjo do te perbente nje rast qe do te provokonte zbatimin e nenit 13 te Rregullores se Kredise te BKE.

4.1.3 Procedurat

Para se te behet ndonje disbursim tek kontraktoret, Huamarresi, nepermjet FZHSH-së, duhet t'i dergoje guvernatorit per miratim brenda periudhes se specifikuar ne nenin e mesiperm 4.1.2 nje flete te dhenash mbi komponentet ne fjale (shtojca V), duke permbledhur karakteristikat per cdo komponent, daten e fillimit dhe gjendjen e ecurise se tij.

4.2. Zbatimi i projektit

4.2.1 Dispozitat e pergjithshme

Huamarresi duhet te tregoje gjithe kujdesin dhe interesin e duhur dhe duhet te perdore te gjitha mjetet ne veçanti ato financiare, teknike, sociale dhe menaxhuese si dhe ato lidhur me mbrojtjen e ambientit te cilat jane te domosdoshme per zbatimin si duhet te projektit.

Vecanerisht ai duhet te garantoje, para se te filloje zbatimi i projektit - qe i gjithe financimi, toka dhe e drejta mbi pronen e paluajtshme te cilat jane te domosdoshme jane disponibel dhe se te gjitha asetet dhe instalimet jane te garantuara dhe te mirembajtura.

Per me teper, Huamarresi duhet te marre persiper qe:

Projekti perputhet me Konventat perkatese te Keshillit te Europes;

Projekti respekton mjedisin ne baze te konventave perkatese nderkombetare;

Financimi i pjesshem nga BKE-ja nuk i kalon 50% te kostos totale te projektit duke perjashtuar taksat, interesat dhe detyrimet financiare.

4.2.2 Prokurimi

Te gjitha prokurimet e punimeve, mallrave dhe sherbimeve qe do financohen sipas projektit nga kredia e BKE-së, duhet te prokurohen ne perputhje me Udhezuesin e prokurimeve te Bankes Boterore te rishikuar ne janar 1999, duke perdorur Dokumentet Standarde te tenderit te Bankes Boterore (maj 2000) dhe Udhezuesin e Bankes Boterore per perzgjedhjen dhe punesimin e konsulentit, rishikuar ne janar 1999.

Procedurat e prokurimit jane percaktuar ne shtojcen VII.

BKE-ja nuk do te jape "no–objection" per rregullimet prokuruese te propozuara nga Huamarresi, perfshire kontraten, procedurat e aplikueshme, por rezervon te drejten te kryeje nje para ose pas rishikim te dokumentave te prokurimit mbi bazen e nje modeli.

4.3 Raportimet e Huamarresit

4.3.1. Raportimet mbi ecurine e Projektit

Huamarresi nepermjet ADF-së duhet t'i dergoje BKE-së te pakten dy here ne vit qe nga disbursimi i kredise deri ne perfundimin e te gjithe projektit, nje raport ku te jepen hollesi mbi:

- vendin ku do te perdoret kredia;
- progresin e planit financiar te projektit;
- progresin e vete projektit;
- hollesi mbi manaxhimin e projektit;
- zbatimin e procedurave prokuruse.

Shtojca V specifikon procedurat lidhur me kete raport dhe ne veçanti pasqyrat monitoruese per projektin dhe kredine qe duhet ------ minimumi-----te jene perfshire.

4.3.2. Raporti i perfundimit te projektit

Me perfundimin e projektit ne teresi, Huamarresi nepermjet PCU-së duhet te garantoje qe BKE do te pajiset me nje raport perfundimtar i cili te permbaje nje vleresim te efekteve ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore te projektit.

4.4. Informacion derguar BKE

Huamarresi, me ane te ADF-së, duhet te mbaj te dhenat e kontabilitetit lidhur me projektin, te cilat duhet te jene ne perputhje me standardet nderkombetare dhe duhet te tregojne ne çdo rast gjendjen e ecurise te projektit dhe, duhet te regjistroje te gjitha veprimet e kryera, te identifikoje asetet dhe sherbimet e financuara me ndihmen e kredise aktuale.

Huamarresi duhet t'i kete llogarite financiare te projektit te kontrolluara ne baze vjetore nga nje odit i pavarur i miratuar nga BKE-ja. Oditi do te financohet nga kredia aktuale. Huamarresi duhet t'i dergoje BKE-së, sa me shpejt qe te jete e mundur, por ne çdo rast jo me vone se 6 muaj nga perfundimi i çdo viti, nje kopje te certifikuar te raportit te kontrollit kryer nga oditi ne fjale.

Huamarresi merr persiper te mireprese çdo mision informimi te ndermarre nga punonjesit e Bankes se Keshillit te Europes, ose nga konsulente te jashtem te rekrutuar nga Banka e Keshillit te Europes si dhe, te siguroje te gjithe bashkepunimin e duhur per misionin e tyre duke i mundesuar çdo vizite te mundshme ne terren te projektit.

Huamarresi merr persiper t'i pergjigjet brenda nje periudhe te arsyeshme çdo kerkese per informacion nga Banka e Keshillit te Europes, dhe t'i siguroje asaj çdo dokumentacion qe BKE-ja e mendon te nevojshme per zbatimin e drejte te Marreveshjes ne fjale, veçanerisht per çeshtjet e monitorimit te Projektit, siç eshte pershkruar ne shtojcen 1 dhe perdorimit te kredise.

Huamarresi duhet te njoftoje menjehere BKE-në per çdo amendament rregullues ose legjislativ ne sektorin ekonomik qe ka te beje me projektin pershkruar ne shtojcen 1 dhe ne pergjithesi

per çdo rast qe mund te ndikoje ne zbatimin e detyrimeve te tyre sipas Marreveshjes aktuale te Kredise.

Çdo amendament legjislativ ose rregullues ne sektorin ekonomik lidhur me Projektin pershkruar ne shtojcen 1 do te perbente nje rast, siç eshte treguar dhe ne nenin 3 te Rregullores se Kredise se Bankes te Keshillit te Europes, qe mund te çonte ne pezullimin, anullimin ose ne rikthimin e menjehershem te kredise.

Neni 5
Perfundimi i detyrimeve te Huamarresit

Pagesa e gjithe shumave te detyrueshme siç eshte theksuar dhe ne Vertetimin Premtues (Promissory Note) e liron Huamarresin nga detyrimet e tij te percaktuara ne neni 3 me siper.

Pasi e gjithe shuma e papaguar e kredise fillestare dhe te gjithe interesat dhe shpenzimet e tjera qe rezultojne nga kjo kredi, ne veçanti shumat e permendura ne nenet e meposhtme 6 dhe 7 te jene paguar sipas rregullit, atehere Huamarresi do te jete plotesisht i liruar nga detyrimet e tij kundrejt Bankes se Keshillit te Europes me perjashtim te atyre percaktuar ne nenin 4.

Neni 6
Interesi per vonesat

Pavaresisht nga ndonje perdorim tjeter i justifikueshem tek BKE-ja sipas Marreveshjes aktuale dhe Rregullores se Kredise, ose ndryshe, ne rast se Huamarresi nuk paguan te gjithe interesat ose ndonje shume qe duhet paguar sipas Marreveshjes aktuale te Kredise jo me vone se afati i percaktuar, Huamarresi duhet te paguaj interes shtese mbi shumen e papaguar dhe jo te papaguar plotesisht me nje interes mujor LIBOR te pageses se fundit sipas dates se caktuar (ne rast se nuk eshte percaktuar ditpuna ne diten e pare qe vijon) ne oren 11.00 paradite (sipas ores lokale ne Londer) + 2,5% ne vit qe nga data e caktuar e kesaj shume deri ne daten e pageses aktuale. Norma e aplikueshme mujore LIBOR duhet te azhornohet çdo 30 dite.

Neni 7
Kostot shoqeruese

Te gjitha detyrimet dhe taksat e çdo lloji, per t'u paguar dhe te paguara, dhe te gjitha shpenzimet qe rrjedhin si rezultat i perfundimit, ekzekutimit, likuidimit, anullimit ose pezullimit te kesaj Marreveshjeje, ne teresi ose pjeserisht, ose nga garancia ose rifinancimi i kredise se dhuruar se bashku me te gjitha aktet ekstra-ligjore qe ka kjo kredi qe nga origjina, do te perballohen nga Huamarresi.

Megjithate, dispozitat e nenit 25 te kapitullit 4 te Rregullores se BKE-së per kredine do te aplikojne, lidhur me kostot e arbitrazhit, proceduren e cituar ne kapitullin 4 ne fjale.

Neni 8
Siguria

Huamarresi deklaron se nuk ka bere dhe as do beje ne te ardhmen ndonje premtim qe t'i jape nje pale te trete nje favor privilegjues, nje te drejte favorizuese te pageses, nje kolateral ose garanci te çdo lloji, pra çdo gje qe mund te jape me shume te drejta mbi palet e treta. (tani e tutje e quajtur siguri).

Megjithate, nese nje siguri e tille i eshte dhene pales se trete, Huamarresi bie dakord qe te formulojë ose te jape nje siguri te ngjashme ne favor te BKE-së ose, aty ku ajo nuk mund te beje nje gje te tille, nje siguri ekuivalente dhe te percaktoje formulimin e nje sigurie te tille ne favor te BKE-së.

Mos respektimi i ketyre dispozitave mund te perbeje nje rast te mangesive siç eshte percaktuar ne nenin 13 te kapitullit 3 te Rregullores se BKE-së dhe mund te çoje ne pezullimin, anullimin ose ne rikthimin e menjehershem te kredise.

Neni 9
Marredheniet me palet e treta

Huamarresit nuk i lejohet qe te krijoje ndonje problem, brenda kuadrit te perdorimit te kredise, lidhur me marredheniet e tij me palet e treta, qe pengon qofte plotesisht ose pjeserisht realizimin e detyrimeve qe rezultojne nga Marreveshja aktuale e Kredise. BKE nuk duhet te perfshihet ne debate te cilat mund te lindin midis Huamarresit dhe paleve te treta dhe shpenzimet, te çdo natyre qofshin, te kontraktuara nga BKE si rezultat i ndonje mosmarreveshje, veçanerisht shpenzimet per proçeset gjyqesore do te mbulohen nga Huamarresi.

Neni 10
Hyrja ne fuqi

Marreveshja aktuale e Kredise hyn ne fuqi 15 dite mbas publikimit ne Fletoren Zyrtare, te ligjit me ane të te cilit Parlamenti i Huamarresit ratifikon Marreveshjen aktuale te Kredise.

Neni 11
Ligji i aplikueshem

Marreveshja aktuale e Kredise dhe sigurite e negociueshme lidhur me sa me siper, duhet t'i permbahen rregullave te Bankes se Keshillit te Europes, siç dhe eshte specifikuar ne dispozitat e nenit 1, paragrafi 3, te Protokollit te trete shtese, date 6 mars 1959 ne Marreveshjen e Pergjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Keshillit te Europes date 2 shtator 1949 dhe se dyti, nese eshte e domosdoshme, ligjit Francez. Debatet midis paleve ne kete Marreveshje duhet t'i nenshtrohen arbitrimit sipas kushteve te percaktuara ne kapitullin 4 te Rregullores mbi Kredine te BKE-së.

Neni 12
Interpretimi i Marreveshjes

Huamarresi deklaron se ai ka marre njoftimin per rregulloren e BKE mbi kredine dhe se ka marre nje kopje te saj. Aty ku ka ndonje mosmarreveshje midis ndonje dispozite te çfaredoshme te rregullores se BKE-së mbi kredine dhe ndonje dispozite te farvoshme te kesaj Marreveshjeje, dispozita e kesaj marreveshjeje mbetet ne fuqi.

Titujt e paragrafeve, seksionet dhe kapitujt e Marreveshjes aktuale te Kredise nuk sherbejne per interpretimin e saj. Ne asnje rast nuk duhet te mendohet qe BKE-ja ka lene me qellim menjane ndonje te drejte, qe i eshte dhene asaj nga kjo Marreveshje.

Neni 13
Zbatimi i vendimit te arbitrazhit

Palet kontraktuese bien dakord qe te mos shfrytezojne ndonje privilegj, imunitet tek ndonje autoritet ekzekutiv qofte ky vendas apo nderkombetar, me qellim qe te kundershtojne zbatimin e vendimit te arbitrazhit, percaktuar ne dispozitat e percaktuara ne kapitullin 4 te Rregullores mbi Kredine te Bankes se Keshillit te Europes.

Neni 14
Perfaqesimi dhe garancite

Huamarresi perfaqeson dhe garanton se:

- organet e tij kompetente e kane autorizuar ate te lidhë Marreveshjen ne fjale dhe i kane dhene te drejten e nenshkrimit, ne perputhje me ligjet , dekretet, rregulloret, nenet e asociimit dhe tekstet e tjera te aplikueshme per te;
- kryerja dhe realizimi i Marreveshjes aktuale nuk i kundervihet ligjeve, dekreteve, rregulloreve dhe teksteve te tjera te aplikueshme per te dhe se te gjitha lejet, licensat dhe autorizimet e duhura jane marre dhe do jene te vlefshme gjate gjithe periudhes se Kredise.

Ndonje ndryshim lidhur me perfaqesimin dhe garancite e mesiperme duhet, gjate gjithe kohes se kredise, te behet e ditur menjehere ne BKE shoqeruar me nje dokument mbeshtetes.

Neni 15

Marreveshja e Kredise eshte hartuar ne dy kopje origjinale ne anglisht dhe secila prej tyre eshte e barazvlefshme.

Nje origjinal ruhet nga secila pale kontraktuese

SHTOJCA I
SINTEZA E PROJEKTIT

I

F/P:	1397 (2001)
Huamarrësi	Republika e Shqipërisë
Shuma e miratuar	3,400,000 US$

II.

Zonat e ndërhyrjes:	Programi parashikon infrastrukturat sociale që lidhen me përmirësim rural, shëndetësinë, arsimin, mbrojtjen e ambientit dhe ato të planifikuara për përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat urbane të cilat janë të gjitha fusha të pranueshme veprimi sipas Rezolutës 1424 (97) rishikimi i 3, për të fuqizuar kohezionin social në vend.
Punimet e planifikuara:	- rrugë rurale;
	- rrjetë ujësjellësish (këto rrjete nuk varen nga ndërmarrja e shërbimit publik);
	- pasarela dhe ura të vogla, pronë e komunës;
	- mbrojtja nga vërshimet dhe kanalizime të ujrave të zeza;
	- shkolla publike dhe qendra shëndetësore, me kush që këto shërbime të jenë funksionale dhe me organikë të plotë;
	- tregje publike;
	- shërbimi sanitar dhe infrastruktura ambientale;
	- rrugë dhe trotuare;
	Punimet e infrastrukturës do të bazohen në nevojat e popullsisë lokale dhe duhet të përmbushin objektivat kryesore si më poshtë: - të krijojë punësim;. - të përmirësojë ambientin; - të ndihmojë në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme; - të mbështesë pushtetet dhe organizmat lokale
Menaxhimi i Projektit	Fondi i Zhvillimit Shqiptar
Shtrirja gjeografike e projektit:	Nënprojektet duhet të zbatohen në të gjithë vendin, në zonat rurale, fshatra, qytete dhe veçanërisht në Tiranë.
Plani i financimit	Kosto totale e investimeve: afërsisht 17 400 000 US$ mbuluar nga: BKE: 3.400.000 US$ Republika e Shqipërisë 1.100.000 US$ Përfituesit (pushtetet vendore): 1.500.000 US$ Qeveria Italiane: 2.400.000 US$ IDA (Banka Botërore) 9.000.000 US$

SHTOJCA II

F/P 1397 (2001)…Këst
Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës
LETËR E VEÇANTË
Për Marrëveshjen e Kredisë datë (_____)
Midis

BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EUROPËS
(më poshtë "BKE")
dhe
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
(më poshtë "Huamarrësi")

Kjo Letër e Veçantë dhe Marrëveshja e Kredisë përaktojnë termat dhe kushtet e miratuara për këstin e parë referuar nenit [numri] të Marrëveshjes së Kredisë në fjalë.

Shuma e Kredisë	……US$
Maturimi	maturimi përfundimtar [numër] – vjet, me një periudhë pa pagesë [numri] vjet.
Përqindja e interesit qarkullues	6 muaj LIBOR plus ose minus [numri] shkalla bazë (neto) për vit
Pagesë interesi	6 muaj më pas
Numurimi i ditë punës	aktualisht/360, Konventa për modifikimin e ditës së punës
Ditë pune	do të thotë një ditë pune në vendin e monedhës
Data e disbursimit	(data)
Udhëzimet e pagesës	Numri i llogarisë [numri] i [emri i bankës dhe shtetit] SWIFTCODE nëpërmjet [emri i bankës korresponduese dhe shteti] SWIFT CODE;

Tekst për interesin bazë LIBOR dhe struktura e Kredisë

Norma e interesit do të llogaritet për çdo [numri] muaj duke filluar nga data e disbursimit. Interesi do të fiksohet dy ditët e punës [në Londër] para çdo periudhe të re interesi sipas "Shoqatës së Bankierëve Britanikë". BKE do të informojë Huamarrësin për interesin e pagueshëm çdo [numri] muaj. Pagesa e interesit do të bëhet në [ditën, muajin]1 të çdo viti dhe për herën e parë në [datën]. Principali do të shlyhet për herë të parë në [datën].

[shëno datat e maturimit dhe shumën e principalit për t'u paguar për çdo datë].

Teksti për interesin bazë LIBOR dhe struktura e kredisë

Norma e interesit do të llogaritet për çdo periudhë [numri] mujore duke filluar nga data e disbursimit. Interesi fiksohet në dy ditët e punës [në Londër] para çdo periudhe të re interesi, sipas "Shoqatës së Bankierëve Britanikë". BKE do të informojë Huamarrësin për interesin që do të paguhet në çdo (numri) muaj. Pagesa e interesit do të bëhet në [datën, muajin] të çdo viti, dhe për herë të parë në (data). Principali do të shlyhet në një këst në [data].

Të gjitha pagesat do të bëhen në llogari të BKE-së në (emri i bankës së shtetit).

Këto dispozita i nënshtrohen marrëveshjes "Konventa për modifikim e ditës së punës", përcaktimi i së cilës gjendet në Shtojcën (numër) të Marrëveshjes së Kredisë, nënshkruar midis BKE-së dhe Huamarrësit në [data].

Për të aktivizuar këtë këst kredie, Huamarrësi duhet t'i dërgojë BKE-së, në kohën e duhur, një vërtetim premtues që i korrespondon këtij kësti [Shih Shojcën 1].

[vendi, data][vendi, data]
Për Bankën për Zhvillim të Këshillit të EuropësPër (emri i Huamarrësit)

SHTOJCA III A

(përqindja fikse e interesit)
F/P 1397 (2001)-[n] Kësti
VËRTETIM PREMTUES
(MONEDHA) (SHUMA)[Data]

Për vlerën e marrë, Republika e Shqipërisë,

me anë të këtij vërtetimi-premtues, premton t'i paguajë Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës, shumën fillestare prej:

[SHUMA me shkrim] [MONEDHA me shkrim],

[1] Shëno 4 data për pagesat 3-mujore dhe 2 data për pagesat 6-mujore

në këstet sipas datave tashme të përcaktuara, dhe interesat siç janë përcaktuar, çdo 6 muaj.

Në datat e përcaktuara, pagesa do të bëhet për një shumë totale përfshirë detyrimin e rimbursimit mbi primcipalin dhe interesin mbi saldon e papaguar të principalit.

[Datë][Monedha][Shuma]

……

Pagesat e mësipërme do të bëhen tek:

[Banka korresponduese e BKE dhe llogarinë referuese],

në favor të BKE pa zbritje për ose në llogari të ndonjë takse aktuale apo të ardhshme, ose ndonjë detyrimi të imponuar ose të vënë në kundërshtim me këtë vërtetim premtues, ose shumë prej ose nga vendi nënshkrues ose nga ndonjë organizëm politik apo i vënies së taksave.

Ky vëretim premtues përbën një lidhje të kredisë së dhënë nga BKE-ja tek Huamarrësi në datën [Data e Disbursimit].

Në rast të mospagimit të menjëhershëm dhe të plotë të ndonjë shume të detyrueshme sipas këtij vërtetimi premtues, i gjithë principali dhe interesat mbi të bëhen menjëherë të detyrueshme dhe duhet të paguhen në datën e pagesës sipas opsionit dhe kërkesës së Huadhënësit.

Dështimi i huadhënësit për të ushtruar ndonjë të drejtë tani e tutje nuk do të thotë heqje dorë nga ndonjë e drejtë e tij në këtë apo atë rast.

Për REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

SHTOJCA III B

(Përqindja jo fikse e interesit)

F/P 1397 (2001)-[n] këst

VËRTETIM PREMTUES

(MONEDHA)(SHUMA)(DATA)

Për vlerën e marrë, Republika e Shqipërisë,

me anë të këtij vërtetimi-premtues angazhohet të paguajë në BKE shumën e principalit prej:

[SHUMA me shkrim] [MONEDHA me shkrim],

në këstet, sipas datave të specifikuara më poshtë

[DATA]:[MONEDHA] [SHUMA]

[DATA]: [MONEDHA] [SHUMA]

[DATA]:[MONEDHA] [SHUMA]

[DATA]: [MONEDHA] [SHUMA]

…/…

dhe me interesat të përcaktuara në artikullin 3.1 të Marrëveshjes së Kredisë, nënshkruar në [data]

Shumat e mësipërme do të bëhen në:

[Banka korresponduese e BKE dhe llogarinë referuese],

në favor të BKE-së pa zbritje për ose në llogari të ndonjë takse aktuale apo të ardhshme, ose ndonjë detyrimi të imponuar ose të vënë në kundërshtim me këtë vërtetim premtues ose shume prej ose nga vendi nënshkrues ose nga ndonjë organizëm politik apo i vënies së taksave.

Ky vërtetim premtues përbën një lidhje të Kredisë së dhënë nga BKE tek Huamarrësi në datën [Data e Disbursimit].

Në rast të mospagimit të menjëhershëm dhe të plotë të ndonjë shume të detyrueshme sipas këtij vërtetimi premtues, i gjithë principali dhe interesat mbi të bëhen menjëherë të detyrueshme dhe duhet të paguhen në datën e pagesës sipas opsionit dhe kërkesës së Huadhënësit.

Dështimi i Huadhënësit për të ushtruar ndonjë të drejtë tani e tutje nuk do të thotë heqje dorë nga ndonjë e drejtë e tij në këtë apo atë rast.

Për: REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

SHTOJCA IV

KONVENTA
PËR MODIFIKIMIN E DITË PUNËS

(Në thonjëza:)

Seksioni 4.12. Konventa e ditës së punës. (a) "Konventa e ditës së punës" nënkupton konventën për modifikimin e çdo date përkatëse në rast se bie në ndonjë ditë që nuk është ditë pune. Termat e mëposhtme, kur shoqërohen me termin "Konventa ditë pune" dhe një datë nënkuptojnë se duhet të bëhet një ndryshim në rast se kjo datë bie në një datë që nuk është ditë pune, kështu që:

(i) …(përjashton)…

(ii) Në rast se specifikhet "dita pasuese" ose "e modifikuar", kjo datë do të jetë dita e parë që pason dhe që është ditë pune, në qoftë se kjo datë nuk bie në muajin e ardhshëm kalendarik, në këtë rast kjo datë do të jetë dita e parë në vazhdim dhe që është ditë pune; dhe

(iii)…(përjashton)

(b)…(përjashton)

(mbyll thonjëza)

("Shoqata Ndërkombëtare e Biznesmenëve për Mirëkuptim, 1991 Definacione)

SHTOJCA V

Nënprojektet e zgjedhura nga ADF			
RRETHI			
Komuniteti lokal			
Kryetari i Bashkisë/komunës			
Lloji i investimit			
Emri i objektit			
1) Social dhe teknik			
- Popullsia e interesuar			
- Numri i familjeve të interesuara			
- Përqindja e papunësisë			
- Impakti social			
Objektivat e Projektit			
2) Përshkrimi i punës			
3) Kalendari i punimeve			
		Në total	USD
	Punime		
	Pajisje		
	Asistencë teknike		
	Totali		
4) Impakti ambiental:			

SHTOJCA VI

KREDITË E DHËNA NGA BANKA			
Nr. Kësti: Data e disbursimit: Shuma:			
NËNPROJEKTET		Financimi i BKE-së i përdorur	
Emri	Vendi	Totali	USD

TOTALI			

SHTOJCA VII

KATEGORIA	VLERA E KONTRATËS (USD 000)	METODA E PROKURIMIT
Mallra	Mbi 100	Tender i hapur ndërkombëtar
	Ndërmjet 10 dhe 100	Blerje Ndërkombëtare
	Nën 10	Blerje
		Të tjera
Punime	Mbi 750	Tender i hapur ndërkombëtar
	Ndërmjet 250 dhe 750	Tender i Hapur Kombëtar
	Nën 250	Me tre kuotime
		Të tjera
	Mbi 150 për kompanitë	Zgjedhje bazuar në kosto dhe cilësi, QCBS
Konsulentë	Nën 150 për kompanitë	Zgjedhje bazuar në cilësi, QBS
	Mbi 150 për individët	Zgjedhje në bazë të kostos më të ulët, LCS
	Nën 150 për individët	Kualifikime

L I G J
Nr. 8961, datë 24.10.2002

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7870, DATË 13.4.1994 "PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", ME NDRYSHIMET PËRKATËSE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.7870, datë 13.4.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8005, datë 4.10.1995, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në fund të nenit 1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
""Rrjeti i hapur farmaceutik" përfshin farmacitë dhe depot e barnave".

Neni 2

Shkronja “b” në pikën 2 të nenit 4 ndryshohet si vijon:

“b) shpenzimet e shërbimit nga mjeku i përgjithshëm ose i familjes, mjeku specialist, infermierët e shërbimit shëndetësor parësor për të gjithë të siguruarit”.

Neni 3

Pas nenit 4 shtohen nenet 4/1 dhe 4/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1

Sigurimet shëndetësore vullnetare

Shtetasit mund të sigurohen vullnetarisht në skemat e sigurimeve vullnetare, kur për një kohë dhe shkaqe të arsyeshme nuk mund të sigurohen detyrimisht.

Sigurimi vullnetar, i parashikuar nga kjo dispozitë, bëhet në kushtet e përcaktuara nga Rregullorja e Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Neni 4/2

Sigurimet shëndetësore suplementare

1. Sigurimet shëndetësore suplementare janë një skemë e sigurimit të detyrueshëm për të punësuarit, sipas përcaktimit të bërë nga ligji nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.

2. Masa e kontributit që paguajnë personat e siguruar, në përputhje me nenin 5 të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996, është 1 për qind e shumës bruto të listëpagesave.

3. Lloji dhe masa e përfitimeve dhe shërbimeve të mbuluara nga sigurimet shëndetësore suplementare caktohen me ligj të veçantë.”.

Neni 4

Pikat 1 dhe 2 të nenit 12 ndryshohen si vijon:

“1. Të gjithë të siguruarit janë të detyruar të regjistrohen në ISSH për efekt të sigurimeve shëndetësore. Regjistrimi i të punësuarve bëhet nga punëdhënësi i tyre.

2. Mosregjistrimi i të siguruarve dhe vonesa në pagesën e kontributeve përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen përkatësisht:

a) mosregjistrimi me gjobë sa dyfishi i kontributit për të gjithë periudhën e mosregjistrimit;

b) për kontributet e derdhura jashtë afateve të caktuara, kamatëvonesa do të jetë:

- 0,05 për qind për ditë të shumës së papaguar të kontributeve, duke filluar nga dita kur pagesa duhej të ishte bërë, për rastet kur është bërë regjistrimi në organet e sigurimeve shoqërore;
- 0,1 për qind për ditë të shumës së papaguar të kontributeve, duke filluar nga dita kur pagesa duhej të ishte bërë, për rastet kur nuk është bërë regjistrimi në organet e sigurimeve shoqërore.”.

Neni 5

Pas nenit 12 shtohen nenet 12/1 dhe 12/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 12/1

Të punësuarit janë të detyruar të pranojnë kontrollin (verifikimin) nga specialistët e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për shërbimet e përfituara.

Neni 12/2

Janë kundërvajtje administrative:

- Mospranimi i kontrollit nga specialistët e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor;
- përfitimet e padrejta, kur nuk përbëjnë vepër penale.

Shkeljet e mësipërme dënohen me:

a) gjobë deri në 5 000 lekë dhe shpërblimin e dëmit;

b) heqjen e së drejtës për përfitimin nga Sigurimet Shëndetësore deri në 1 muaj.

Gjobat vendosen nga specialistët e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe ekzekutimi i tyre bëhet në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative" me ndryshimet përkatëse."

Neni 6

Në nenin 14 fjalia e dytë ndryshohet si vijon:

"Rregullat për përcaktimin e masës së shpërblimit vendosen nga Këshilli Administrativ i ISKSH-së."

Neni 7

Në nenin 15 shtohet pika 1 shkronja "a" me këtë përmbajtje:

"Lista e barnave që rimbursohen hartohet nga një komision teknik i quajtur "Komisioni i Hartimit dhe Rishikimit të Listës së Barnave të Rimbursueshme" dhe nga "Komisioni i Çmimit të Barnave" (KÇB) të ngritur me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë. Në këtë komision Shoqata e Grosistëve Farmaceutikë ka përfaqësuesin e saj. Kjo listë miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë.".

Neni 8

Në nenin 23, pas shkronjës "e" shtohet shkronja "ë" me këtë përmbajtje:

"ë) Përcakton dhe miraton strukturën e punonjësve të ISKSH-së, si dhe pagat e tyre.".

Neni 9

Shkronja "b" e pikës 1 të nenit 25 ndryshohet si vijon:

"b) regjistrimin e të gjithë personave të siguruar, sipas skemës së sigurimit të detyrueshëm dhe vullnetar, të përcaktuar nga ky ligj, dhe pajisjen me kartën e sigurimit dhe me numrin e identitetit.".

Neni 10

Në nenin 26 bëhen këto ndryshime e shtesa:

Paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"ISKSH-ja lidh kontratë me farmacitë, depot e barnave dhe me mjekët e familjes që plotësojnë kriteret e vendosura nga Këshilli Administrativ. Kjo kontratë është kontratë mes palëve, ku parashikohen të drejtat dhe detyrimet reciproke.".

Në paragrafin e tretë, pas fjalës "farmacitë" shtohen fjalët "depot e barnave".

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3592, datë 10.12.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

L I G J
Nr. 8962, datë 24.10.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8734, DATË 1.2.2001 "PËR GARANTIMIN E SIGURISË SË PUNËS TË PAJISJEVE DHE TË INSTALIMEVE ELEKTRIKE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8734, datë 1.2.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike", fjalët "Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit" zëvendësohen me "ministria përgjegjëse për sektorin elektroenergjetik".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3593, datë 10.12.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

L I G J
Nr. 8963, datë 24.10.2002

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995
"PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR", ME NDRYSHIMET PËRKATËSE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", me ndryshimet përkatëse, pas nenit 25/4 shtohet neni 25/5 me këtë përmbajtje:

"Neni 25/5

1. Furnizimi falas, si ndihmë për situatat e përcaktuara, sipas ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile", është furnizim i përjashtuar.
2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përcaktojë rregullat për rastet e përjashtimit të ndihmave që jepen në rastin e emergjencave civile.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3594, datë 9.12.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr. 8970, datë 14.11.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8739, DATË 12.2.2001 "PËR GARANTIMIN E SIGURISË SË PUNËS TË PAJISJEVE NËN PRESION"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8739, datë 12.2.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve nën presion", fjalët "Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit" zëvendësohen me fjalët "Ministria përgjegjëse për industrinë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3595, datë 9.12.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

D E K R E T
Nr. 3572, datë 27.11.2002

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Gëzim Shahin Omari
2. Dhurata Demir Frankenhauser (Uliu)
3. Çlirim Hekuran Kuburi
4. Adriano Ibrahim Metushi
5. Laver Jonuz Cenolli
6. Ergys Laver Cenolli
7. Hysen Sulejman Çela
8. Janina Hysen Çela
9. Gabriela Hysen Çela
10. Tatjana Xhevdet Çela (Bajrami)
11. Ramazan Beqir Karaj
12. Besmir Ramazan Karaj
20. Nadine Bardhyl Pollozhani
21. Nil David Bardhyl Pollozhani
22.Eladjona Enver Pollozhani(Bardhollari)
23. Denis Vangjel Hyka
24. Hektor Mahmut Myftiu
26. Sonja Hektor Myftiu
27. Mimoza Qazim Myftiu (Shtylla)
28. Agim Hysen Ramaj
29. Emirjam Agim Ramaj
30. Arlinda Agim Ramaj
31. Teuta Shyqyri Dervishi
32. Albana Albert Shala

13. Petrit Belul Krasniqi
14. Dalina Agim Bytyqi (Meça)
15. Donald Qemajl Bytyqi
16. Daniel Qemajl Bytyqi
17. Merita Novruz Schmitt (Xhoxhaj)
18. Adrian Micol Haxhiaj
19. Bardhyl Agim Pollozhani
33. Lulëzim Selami Sulollari
34. Besiana Fatmir Rançi
35. Astrit Isuf Kotzbauer (Çorja)
36. Adrijan Zyhdi Hysa
37. Amarildo Zyber Zela

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

D E K R E T
Nr. 3576, datë 27.11.2002

PËR DHËNIE DHE LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 11, 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të prindërve dhe me pëlqimin e tyre:
1. Valbona Imer Ademi
2. Valon Imer Ademi
3. Arben Imer Ademi

Neni 2

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:
1. Altin Lenin Jaho
2. Alfert Shaban Çollaku
3. Mirsa Viktor Adami
4. Helenita Viktor Mannsberger (Hykollari)
5. Tatjana Misir Daka
6. Anila Çomo Memaçi (Kapaj)
7. Bujar Rexhep Krasniqi

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

Shpallje kërkese për shpronësim

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim publik të pasurive të paluajtshme për ndërtim të objektit "Segmentit rrugor Link-Road, që lidh Interchange Shkozet, me rrugën nacionale Tiranë-Durrës".

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është D.P.Rrugëve

Me anë të këtij publiki në shtyp, kërkojmë të vemë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Shpronësimit pranë Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

Ky publikim do të jetë për një periudhë njëjavore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personat që kanë emrat në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit (Drejtoria e Monitorimit).

REPUBLIKA E SHQIPERISE
QARKU : DURRES

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER SHKAK TE NDERTIMIT TE SEGMENTIT RRUGOR " LINK ROAD " PJESE E

26	Fatos		Zdrava	5/313			0		131	2000	262000				262000	
27	Asllan		Zdrava	5/313			0		131	2000	262000				262000	
28	Agron		Zdrava	5/313			0		131	2000	262000				262000	
29	Shpresa		Zdrava	5/313			0		131	2000	262000				262000	
30	Dhurata	Asllan	Meta	1/209-210			0		1559	2000	7986000	1559	3500	5456500	13442500	plotesim dokumenti
		SHUMA			**2260**	**1600**	**3616000**	**472170**	**5552**	**2000**	**15972000**	**1643**		**6550432**	**26610602**	

Shenim; Brenda afatit ligjor 15 dite pas publikimit, te gjithe pronaret qe jane me shenimin; plotesim dokumenti,pretendim pronesije dhe konflikt, te paraqesin dokumentacionin e nevojshem ligjor (certifikate pronesije, harte treguese , kartele) te noterizuara prane Sektorit te Shpronesimeve ne Drejtorine e Monitorimit .

10	Skender	Sadri	Kapiti	4/254	110	1600	176000	116430							292430	
11	Sherif	Rexhep	Domi	4/272			0	88050	149	2000	298000	66	13023	859518	1245568	plotesim dokumenti
12	Mehdi	Zenel	Luka	4/276			0		80	2000	160000				160000	Konflikt
	Ismail	Ali	Gjini	4/264												
13	I paidentifikuar			4/278			0		114	2000	228000				228000	Konflikt
	Ismail	Ali	Gjini	4/264												
14	Ram	Jashar	Dushaj	5/534			0	124190	60	2000	120000				244190	plotesim dokumenti
15	Halil		Kurtbalaj	5/533			0		200	2000	400000				400000	
16	Valdet	Jonuz	Myqelefi	5/468			0		43	2000	86000				86000	
17	Fadil	Hysni	Dida	5/466			0		240	2000	480000				480000	
18	Gezim	Brahim	Kurtbalaj	5/526			0					18	13023	234414	234414	
19	I paidentifikuar		km 0.700	5			0		619	2000	1238000				1238000	pretendim pronesie
20	I paidentifikuar		km 0.800	5			0		1002	2000	2004000				2004000	pretendim pronesie
21	I paidentifikuar		km 0.690	5			0		438	2000	876000				876000	pretendim pronesie
22	Naze		Deliallisi	5/313			0		131	2000	262000				262000	
23	Ilmi		Deliallisi	5/313			0		131	2000	262000				262000	
24	Engjellushe		Fani	5/313			0		131	2000	262000				262000	
25	Abdulla		Deliallisi	5/313			0		131	2000	262000				262000	

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:
- Kodin Penal (të azhurnuar);
- Kodin e Procedurës Penale (të azhurnuar);
- Përmbledhjen e legjislacionit në fushën e transporteve (Kodin Rrugor dhe ligjin për transportet, e azhurnuar);



U dorëzua për shtyp më 11. 12. 2002
Doli nga shtypi më 12. 12. 2002

Tirazhi: 4250 copë Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë